



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2464 Prot.

Tiranë, më 05.10 2023

VENDIM
Nr. 103 datë 05.10 2023

PËR
PJESËMARRJEN E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
SI PARTNER NË KONFERENCËN E 4-T SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
NË EDUKIM FIZIK, SPORT DHE SHËNDET
TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT
UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Mbështetur në nenin 3 dhe 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 95 datë 28/09/2023 “Për propozimin e pjesëmarrjes së UST si partner në Konferencën e 4-t Shkencore Ndërkombëtare në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit / Universiteti i Prishtinës”, Senati akademik në mbledhjen e tij të datës **05.10.2023**,

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në *Konferencën e 4-t Shkencore Ndërkombëtare në Edukim Fizik, Sport dhe Shëndet*, e cila do të organizohet në datat **17-18 nëntor 2023** në *Prishtinë, Republika e Kosovës*.
2. Anëtarët e Bordit Shkencor përfaqësues të UST të kësaj konference janë si vijon:
 - ✓ Prof.Asc.Dr. Najada Quka - staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes;
 - ✓ Dr. Dritan Sallaku - staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes;
 - ✓ Dr. Rando Kukeli - staf akademik pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.
3. Përfaqësuesve të Rektoratit dhe anëtarëve të Bordit Shkencor të kësaj konference nga UST, t’i mundësohet mbulimi i të gjitha shpenzimeve të pjesëmarrjes.
4. Stafit akademik dhe atij kërkimor shkencor pjesëmarrës në këtë konferencë, t’i mundësohet mbulimi i shpenzimit të transportit.

5. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
6. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të Institucionit.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi njësitë kryesore të UST.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

